



QEVERIA E KOSOVËS KRU Hidromorava



Banka Investuese Evropiane



Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Infrastruktura e ujërave të zeza në Gjilan & Mitrovicë

**Gjilan, Shtojca Teknike përfshirë
Shpalosjet Mjedisore dhe Sociale**

Përmbledhje Jo-Teknike

Final

Data: 05 mars 2019

Autor(ët):	Laszlo Czuczor, Heidi Hjorth, Fritz Schwaiger
Rishikimi:	02
Arkivimi dhe emri i fajllit:	T:\2695\17 XK Gjilan+Mitrovica WWTP\Reports\E+S Reports Gjilan\Translated Albanian\Final 20190305\Gjilan NTS 20190305 alb.docx
Redaktimi i fundit:	05 Mars 2019

SHKURTESAT

RRKK	Rrjedhë e Kombinuar Kanalizimi
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
VNM	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor
BIE	Banka Investuese Evropiane
PVMS	Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social
SHMS	Shpalosjet Mjedisore dhe Sociale
SF	Studimi i Fizibilitetit
NTS	Përmbledhje Jo-Teknike
PE	Ekuivalent Popullate
KRUH	Kompania Rajonale e Ujësjetit Hidromorava
PAA	Plani për angazhimin e akterëve
WBIF	Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor
FTUZ	Fabrika për Trajtimin e Ujërave të Zeza

PËRMBLEDHJA

1	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	4
1.1	HISTORIKU I PROJEKTIT	4
1.2	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	4
1.3	ASPEKTET LIGJORE DHE PËRPUTHSHMËRIA	5
1.4	ASPEKTET MJEDISORE DHE SOCIALE	5
2	PËRMBLEDHJE E PËRFITIMEVE MJEDISORE, NDIKIMET E MUNDSHME TË KUNDËRTA, MASAT ZBUTËSE DHE MENAXHUESE	6
2.1	NDIKIMET POZITIVE DHE PËRFITIMET NGA INVESTIMET	6
2.2	SHQYRTIMET MJEDISORE DHE MASAT ZBUTËSE	6
3	PËRMBLEDHJE E PËRFITIMEVE SOCIALE, NDIKIMET E MUNDSHME TË KUNDËRTA, MASAT ZBUTËSE DHE MENAXHUESE	7
3.1	NDIKIMET POZITIVE DHE PËRFITIMET NGA INVESTIMET	7
3.2	SHËNDETI DHE SIGURIA E KOMUNITETIT	7
3.3	SHËNDETI DHE SIGURIA NË PUNË	8
3.4	BLERJA E TOKËS DHE ZHVENDOSJA EKONOMIKE	8
4	KOMUNIKIMI	9
4.1	PLANI PËR ANGAZHIMIN E AKTERËVE	9
4.2	MEKANIZMI I ANKESAVE	9
4.3	KONTAKTET	9

1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1.1 HISTORIKU I PROJEKTIT

Qeveria e Kosovës ka kërkuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Investuese Evropiane (BIE) që të mbështesin ndërtimin e Fabrikave për trajtimin e ujërave të zeza (FTUZ) dhe infrastrukturës së ndërlidhur të kanalizimit në Gjilan dhe Mitrovicë. Studimet e fizibilitetit (SF) për të dy rajonet janë finalizuar në vitin 2013 dhe 2015 me financim nga Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF).

Bankat kanë autorizuar Posch & Partners që të përgatisin një Shtojcë Teknike për të dy rajonet për të validuar punën origjinale dhe sipas nevojës të freskojnë informatat shtesë dhe të plotësojnë çdo zbrazëti në informata për të dy Projektet dhe kompanitë e ujësjellësit. Qëllimi ishte që në mënyrë të pavarur të kontrollohet qëndrueshmëria e zgjidhjeve të quajtura Programi i Investimeve Parësore (PIP) të propozuara fillimisht, të rishikohen informatat kryesore dhe të konfirmohen përfitimet e pritura dhe financueshmëria e zgjidhjeve të propozuara. Rishikimi do të zhvillohet bashkë me Shpalosjet Mjedisore dhe Sociale ("SHMS") për të siguruar konsistencën dhe qëndrueshmërinë e projektit.

Ky dokument është një Përmbledhje Jo-Teknike (NTS) e cila paraqet një përmbledhje të Projektit në një gjuhë joteknike që mbulon historikun dhe përshkrimin e projektit, procesin kombëtar të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (VNM), përfitimet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale, masat nxitëse dhe menaxhuese që janë inkorporuar në Planin e Veprimtimit Mjedisor dhe Social (PVMS) dhe hollësitë e komunikimeve me një përmbledhje të Planit për angazhimin e akterëve (PAA) që përfshin një mekanizëm të ankesave.

Ky raport merret me investimet e planifikuara vetëm për Gjilanin.

1.2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i projektit është grumbullimi dhe trajtimi i të gjitha ujërave të zeza në zonën urbane të Gjilanit dhe fshatrat përreth tij përfshirë fshatrat Koretishte, Pasjak dhe Shillovë; Malishevë; Jug të Gjilanit dhe Velekincë, siç shihet në figurën e mëposhtme. Horizonti i planifikuar i projektit është 2032.




Figure 1-1. Shtrirja e Projektit

Elementet e mëposhtme duhet zbatuar në Fazën I:

- Një FTUZ ku bashkohen lumenjtë Morava dhe Mirusha; i projektuar për një kapacitet prej 76,000 ekuivalent popullate (pe) të arritur me dy trena trajtimi me rezervuar Imhoff dhe filtra rrjedhës.
- Zëvendësimi dhe avancimi i kanalizimeve urbane në Gjilan (4,099 m) dhe Velekincë (2,947 m) për të përmirësuar funksionalitetin e rrjetit të kanalizimit.
- Ndërtimi i kanalizimeve të reja në zonën urbane të Gjilanit për të unifikuar rrjetet e fragmentuara ashtu që i tërë kanalizimi të rrjedhë në një pikë të vetme, në RRKK, i cili është edhe fillimi i kolektorit kryesor për të bartur kanalizimin në FTUZ.
 - Kanalizimet nga Koretishta (7,021 m)
 - Kanalizimet nga Shillova (1,120 m)
 - Kycjet e reja dhe kolektorët në zonën urbane (13,328 m)
 - Komora e re RRKK me sisteme të automatizuara (*automated screens*)
 - Gypi i rrjedhjes nga RRKK te pika e shkarkimit (150 m)
- Ndërtimi i kanalizimeve të reja në Velekincë dhe Jug të Gjilanit (4,265 m) për të unifikuar rrjetet ashtu që i tërë kanalizimi të rrjedhë në fillim të kolektorit në Velekincë për ta bartur kanalizimin në FTUZ.
- Ndërtimi i dy kolektorëve të rinj për të bartur kanalizimin në FTUZ.
 - Nga Gjilani (RRKK) në FTUZ (4,682 m)
 - Nga Velekinca në FTUZ (2,269 m)

1.3 ASPEKTET LIGJORE DHE PËRPUTHSHMËRIA

Një Studimi i Fizibilitetit është zhvilluar për projektin.

Një vlerësim i pavarur mjedisor dhe social është ndërmarrë sipas Kërkesave të Performancës nga BERZH / BIE, standardet e BE-së dhe praktikat më të mira. Ky vlerësim është përdorur për të zhvilluar një Plan Veprimi Mjedisor dhe Social (PVMS) për zbatim dhe një pako shpalosëse që përbën këtë përmbledhje jo-teknike dhe një Plan për angazhimin e akterëve (PAA) në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

PAA ofron një kornizë për aktivitete konsultimi dhe informatë për shpalosje të projektit përfshirë metodat e përdorura për aktivitete konsultimi.

1.4 ASPEKTET MJEDISORE DHE SOCIALE

Janë identifikuar ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale si dhe janë zhvilluar masat zbutëse që janë të pranishme në PVMS. KRUH zotohet të sigurojë zbatimin e PVMS. Një përmbledhje e ndikimeve kryesore dhe zbutja e tyre janë paraqitur në seksionet e mëposhtme.

2 PËRMBLEDHJE E PËRFITIMEVE MJEDISORE, NDIKIMET E MUNDSHME TË KUNDËRTA, MASAT ZBUTËSE DHE MENAXHUESE

2.1 NDIKIMET POZITIVE DHE PËRFITIMET NGA INVESTIMET

Projekti pritet të ketë një numër ndikimesh pozitive në mjedis:

- Projekti në masë të konsiderueshme do të zvogëlojë vëllimin e ndotjes në lumenjtë Mirusha dhe Morava dhe eventualisht në Danub
- Vëllimi i zvogëluar i ndotjes në lumenjtë Mirusha dhe Morava gradualisht do të përmirësojë ekosistemin e lumit dhe jeta ujore në këta trupa ujqor do të rehabilitohet
- Numrat e peshqve dhe madhësia do të rriten me një përbërje më të shumëllojshme të botës shtazore. Niveli i ngritur i oksigjenit të tretur në ujën e lumit do të parandalonte mbytjen e peshqve
- Projekti do të ketë ndikim pozitiv në cilësinë e ujërave nëntokësore. Zgjerimi i sistemit të kanalizimit dhe largimi gradual nga gropat septike do ta zvogëlojë ndotjen e ujërave të cekëta nëntokësore, në masë të konsiderueshme, duke ndërprerë infiltrimin e kanalizimit në ujëra nëntokësore.

2.2 SHQYRTIMET MJEDISORE DHE MASAT ZBUTËSE

Aktivitetet ndërtimore do të prodhojnë ndikime afatshkurtra, lokale kryesisht që shoqërohen me ndikimet e zakonshme të lidhura me ndërtimin si zhurma, ndotja e ajrit, qasja e kufizuar në ndërtesa dhe rrugë, ndikimi i mundshëm i vibrimit në ndërtesa, mbeturinat, dëmtimet, dhe ngarkesat në trafik.

Përmes masave përkatëse zbutëse, të gjitha ndikimet negative do të zvogëlohen në nivele të pranueshme. Masat zbutëse janë përshkruar në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS) i cili do të jetë pjesë e kontratave ndërtimore. Kontraktorët do të obligohen të respektojnë përcaktimet e PVMS-së, dhe të gjitha aktivitetet do të monitorohen për së afërmi nga Konsultanti Mbikëqyrës.

Vendi i propozuar për Fabrikën për Trajtimin e Ujërave të Zeza është zonë bujqësore rurale. Nuk ka objekte banimi brenda rrezes prej 500 m nga vendndodhja e FTUZ. Kundërmimi nuk mendohet se ka ndikim në atë zonë.

Aktivitetet ndërtimore do të shkaktojnë shqetësime minimale të speciet lokale të botës shtazore në zonën e punimeve dhe zonat përreth. Rehabilitimi dhe punët ndërtimore me gjasë do të rezultojnë në largimin ose zhvendosjen e disa drunjve dhe bimësisë brenda zonës ndërtimore. Megjithatë, pasi që FTUZ i propozuar në komunën e Gjilanit ndodhet në tokë bujqësore, ndërtimi nuk pritet të ketë ndikim të konsiderueshëm në biodiversitet. Do të ketë një largim të kufizuar të drunjve në korridoret e kyçjeve.

Plani i emergjencës dhe reagimeve do të vendoset për ta menaxhuar ndotjen aksidentale ose fatkeqësitë natyrore. Lirimet e pluhurit do të minimizohen duke optimizuar trafikun ndërtimor, ruajtur kufizimet e shpejtësisë dhe përdorimin e ujit për ta zvogëluar pluhurin. Të gjitha masat e nevojshme do të specifikohen në kontratat e ndërtimit.

3 PËRMBLEDHJE E PËRFITIMEVE SOCIALE, NDIKIMET E MUNDSHME TË KUNDËRTA, MASAT ZBUTËSE DHE MENAXHUESE

3.1 NDIKIMET POZITIVE DHE PËRFITIMET NGA INVESTIMET

Projekti pritet të ketë një numër ndikimesh pozitive në njerëzit që jetojnë në Gjilan dhe fshatrat përreth.

Investimet e propozuara vlerësohet të kenë ndikime të konsiderueshme pozitive. Në përgjithësi, ekonomitë familjare, organizatat, ndërmarrjet ekonomike dhe industriale aktualisht të lidhura me shërbimet e ujërave të zeza do të përfitojnë nëpërmjet shërbimeve të përmirësuara. Për më tepër, KRUH pritet të jetë në pozitë më të mirë që të vendosë lidhje për ujëra të zeza për ekonomi tjera familjare, të cilat pastaj gjithashtu do të përfitojnë nga investimet. Ndikimet tjera pozitive mund të përfshijnë:

- Disa zvogëlime në sëmundjet që lidhen me ujin dhe kanalizimin, rezultojnë me zvogëlim të vdekshmërisë dhe përhapjes së sëmundjeve; kjo do të shpijë në uljen e kostos së shërbimeve shëndetësore për individin, familjen dhe tërë shoqërinë;
- Kushtet e përmirësuara të jetesës dhe mirëqenies, sidomos për njerëzit që jetojnë afër pikave ekzistuese të shkarkimit të lumenjtë Mirusha, Livoq dhe Morava;
- Ndërtimi i një FTUZ-i funksional do të jetë përmirësim i madh i sistemit të tanishëm dhe do të zvogëlojë nivelet e kundërmimit, si dhe do të zvogëlojë ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- Mundësitë për punësim, dhe pastaj të ardhura të rritura për banorët lokal lidhur me investimin e propozuar në infrastrukturën e ujërave të zeza; të ardhurat e rritura mund të shpijnë në kërkesë të shtuar për mallra dhe shërbime dhe rrjedhimisht në rritje të shtuar ekonomike;
- Zhvillimi i resurseve njerëzore në formë të trajnimit kryesisht nga furnizuesit e projektit; niveli i ngritur i njohurive dhe shkathtësive do të ketë përfitime ekonomike për individin, familjen dhe tërë shoqërinë.

3.2 SHËNDETI DHE SIGURIA E KOMUNITETIT

Punët e ndërtimit dhe riparimeve në zonat publike nganjëherë ndeshen me objektet ekzistuese, si gypat e gazit, kabllot e komunikimit, kabllot e rrymës etj, dhe ndodhin ndërprerje të përkohshme të shërbimeve.

Vendosja e rrethojave dhe shenjave përdoren për të informuar publikun në vend për t'u siguruar rrugë alternative rreth vendpunishtes.

Rreziqet për shëndetin dhe sigurinë e komunitetit që shfaqen gjatë punëve të ndërtimit dhe riparimeve përfshijnë pluhurin, zhurmën dhe vibrimet, si dhe bllokimet e trafikut.

Për të siguruar menaxhim efektiv të shëndetit dhe sigurisë së komunitetit, duhet ndërmarrë këto masa:

- Dokumentacioni i kontratës duhet të specifikoj përgatitjen dhe zbatimin e një plani për menaxhimin e trafikut;
- Dokumentacioni i kontratës duhet të specifikoj që punët duhet kryer me përpikëri gjatë orëve të ditës ose me aplikim dhe miratim të veçantë;
- Dokumentacioni i kontratës duhet të specifikoj që vendet e ndërtimit të kenë shenja përkatëse dhe rrethoja.

3.3 SHËNDETI DHE SIGURIA NË PUNË

Për t'u siguruar që shëndeti dhe siguria në punë për punëtorët e ndërtimit të menaxhohen në mënyrë efektive nga kontraktori, duhet ndërmarrë masat në vijim:

- Dokumentacioni i kontratës duhet të specifikoj që procedurat për shëndet dhe siguri të publikohen dhe zbatohen për punëtorët e ndërtimit;
- Dokumentacioni i kontratës duhet të specifikoj një procedurë të veçantë ankesash për punëtorët e kontraktorit.

3.4 BLERJA E TOKËS DHE ZHVENDOSJA EKONOMIKE

Ndërtimi i FTUZ kërkon përvetësimin e rreth 7 ha tokë. Një vend afër fshatit Uglar te lumi Morava është përzgjedhur për FTUZ. Ky vend kërkon blerjen e 36 ngastrave tokë bujqësore (aktualisht të mbjella me misër) për FTUZ, dhe si dhe një ngastër tokë për rrugë.

Nuk nevojitet të blihet tokë për kolektorët në Gjilan dhe Velekincë, të cilët do të shtrihen përgjatë lumenjve Mirusha (4.682 m) dhe Morava (2.269 m).

E drejta e rrugës duhet siguruar për të shtrirë kolektorët afër FTUZ. Duhet marrë masat për të shmangur humbjen e kulturave bujqësore, në rast se kjo nuk mund të shmanget, atëherë duhet kompensuar.

Për t'u siguruar që blerja e tokës të kryhet në pajtim me praktikën më të mirë ndërkombëtare është zhvilluar një Kornizë për Blerjen e Tokës dhe Kthimin e Kushteve të Jetesës për projektin që përcakton procesin e blerjes së tokës sipas BERZH-it, Kërkesa për Performancë 5. Kur të dihen ndikimet e sakta të Projektit, duhet të ndërmerren këto masa:

- Një Plan për Blerje të Tokës dhe Rikthim të Kushteve të Jetesës duhet zhvilluar pasi që të bëhet e ditur shkalla e saktë e blerjes së tokës lidhur me projektin, p.sh. pas zhvillimit të studimeve për shpronësim që kërkohen me legjislacion kombëtar.

4 KOMUNIKIMI

4.1 PLANI PËR ANGAZHIMIN E AKTERËVE

Plani për angazhimin e akterëve (PAA) është përgatitur për projektin, dhe ka përcaktuar kanalet e komunikimit dhe planet për ndërtimin e FTUZ në Gjilan.

PAA synon përmbledhjen e metodave, procedurave, politikave dhe aktiviteteve që do të zbatohen nga Administrata Komunale në Gjilan dhe KRUH për të informuar akterët në një mënyrë përfshirëse dhe me kohë për ndikimet e mundshme të projektit.

PAA përfshin një program të konsultimeve të menjëhershme dhe aktiviteteve të angazhimit të kërkuar për të trajtuar shqetësimet e tanishme të akterëve, si dhe konsultimin e rregullt dhe shpalosjet gjatë tërë ciklit të projektit. Veç kësaj, PAA përfshin një mekanizëm të ankesave, siç paraqitet në vijim.

PAA është në dispozicion në uebfaqet e KRUH dhe të Administratës Komunale të Gjilanit si dhe në formë të shtypur në KRUH dhe në Administratën Komunale të Gjilanit.

4.2 MEKANIZMI I ANKESAVE

Një mekanizëm i ankesave do të zbatohet për të siguruar që Administrata Komunale në Gjilan dhe KRUH t'u përgjigjen të gjitha shqetësimeve dhe ankesave sidomos nga akterët dhe komunitetet e prekura.

Të gjitha komentet ose shqetësimet mund të sillen në Administratën Komunale gojarisht ose me shkrim (përmes postës ose emailit) ose duke plotësuar formularin e ankesave në PAA. Formulari i ankesave do të vihet në dispozicion në zyrën e administratës komunale, shkolla, qendra të komunitetit, dhe vende tjera publike që janë lehtësisht të qasshme për të gjithë akterët relevant, bashkë me një përshkrim të mekanizmit të ankesave.

Të gjitha ankesat do të:

- Regjistrohen në regjistrin e ankesave përfshirë informatat e hollësishme për kontaktim (përveç nëse ankesa është anonime) dhe hollësitë e ankesës;
- Pranohen brenda 7 ditëve,
- Marrin përgjigje jo më vonë se 30 ditë.

4.3 KONTAKTET

Çdo pyetje lidhur me projektin duhet adresuar te:

Administrata Komunale në Gjilan
Bulevardi i Pavarësisë p.n.
Telefoni: 0280 320 781
Email: info.gjilani@rks-gov.net
<https://kk.rks-gov.net/gjilan>

Kreshnik Aliu, Menaxher Projekti
Email: kreshnikaliu@hotmail.com
Telefon: 045 713 113

Ose

Hidromorava
Vëllezërit Gërvalla p.n 60000 Gjilan
Telefon: 44 983 071

Email: info@kru-hidromorava.com
<http://kru-hidromorava.com>

Veton Shaqiri, Coordinator
Email: vetonshaqiri@gmail.com
Telefoni 045 999 961

NjZP mund të kontaktohet edhe nëpërmjet emailit të projektit: infoftuz@gmail.com